



Raport:

Konkluzione nga konsultimet me grupet e interesit për çështjet dhe barrierat më të rëndësishme në sektorin e ndërtimit

Magdalena Błachowiak
Anna Witkowska



 RenovAID

Ky projekt është pjesë e Iniciativës Evropiane për Klimën (EUKI) i Ministrisë Federale Gjermane për Çështjet Ekonomike dhe Veprimin Klimatik (BMWK)

Projekti “RenovAID – Mbështetje Strukturore në shumë nivele për Përmirësimin e Efiçencës së Energjisë në Ndërtesat në Kosovë dhe Shqipëri” synon të rrisë efiçencën energjetike të ndërtesave në këtë rajon. Efiçenca e energjisë është thelbësore për pakësimin e emetimeve të gazeve serrë, uljen e kostove të energjisë dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Ky raport konsolidon gjetjet nga studimet gjithëpërfshirëse të kryera në Kosovë dhe Shqipëri, duke ofruar njohuri mbi barrierat aktuale dhe duke propozuar rekomandime të zbatueshme për politikatat dhe për të përmirësuar efektshmërinë e energjisë në ndërtesa.

Raporti paraqet një pasqyrë të gjendjes aktuale, sfidave dhe rekomandimeve për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa në Kosovë e Shqipëri. Gjetjet kryesore nxjerrin në pah barriera të rëndësishme si kufizime financiare, mungesa e ndërgjegjësimit të publikut dhe korniza e papërshtatshme e politikave. Raporti thekson nevojën për mbështetje të konsiderueshme financiare, fushata të zgjeruara për ndërgjegjësimin e publikut dhe zbatim rregullator më të fortë për të arritur efikasitet në energji. Përpjekjet ndërmjet institucioneve qeveritare, sektorit privat dhe organizatave ndërkombëtare janë thelbësore për të çuar përpara programin e efiçencës së energjisë në përputhje me standardet evropiane.

Supported by:



Federal Ministry
for Economic Affairs
and Climate Action



European
Climate Initiative
EUKI

on the basis of a decision
by the German Bundestag

RenovAID

Multi-level structural support
for improving energy efficiency
in buildings in Kosovo and Albania



WiseEuropa



ENERGIACLUB
CLIMATE POLICY INSTITUTE
APPLIED COMMUNICATIONS

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje /4

1.1 Pak fjalë/ 4

1.1.1. Qëllimi i raportit/ 4

1.1.2. Pyetjet kërkimore / 4

1.2. Metodologjia / 5

1.2.1. Metodologjia e përdorur / 5

1.2.2. Përshkrimi i metodologjisë / 6

1.2.3. Mbledhja e të dhënave: Shqipëria / 7

1.2.4. Mbledhja e të dhënave: Kosova / 8

2. Rezultate / 9

2.1. Shqipëria / 9

2.1.1. Nga intervistat dhe fokus grupi / 9

2.1.2. Përgjigjet e dhëna për pyetjet kërkimore / 9

2.1.3. Shkalla në të cilën përgjigjet konfirmojnë/
përgënjeshtrojnë hipotezën e kërkimit/11

2.2. Kosova / 12

2.2.1. Nga intervistat dhe fokus grupi / 12

2.2.2. Përgjigjet e dhëna për pyetjet kërkimore / 12

2.2.3. Shkalla në të cilën përgjigjet konfirmojnë/
përgënjeshtrojnë hipotezën e kërkimit / 15

3. Konkluzione / 16

3.1. Implikimet më të gjera në legjislacion dhe kushtet sociale në Shqipëri dhe Kosovë/ 16

3.1.1. Shqipëria / 16

3.1.2. Kosova / 16

3.1.3. Diskutime dhe përgjithësim i gjetjeve / 17

3.1.4. Rezultatet si bazë për zhvillimin e udhërrëfyesit afatgjatë
në rinovime në Prishtinë dhe Tiranë / 17

4. Rekomandime / 19

4.1. Shqipëria / 19

4.2. Kosova / 20

5. Shtojca / 21

5.1. Pyetëtori për intervistat/ 21

5.2. Pyetjet për fokus grupin / 25

1. HYRJE

1.1. Pak fjalë

1.1.1. Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është të kontribuojë në përpjekjet e vazhdueshme të projektit RenovAID për të përmirësuar efikasitetin energjetik të ndërtesave në Kosovë dhe Shqipëri. Në këtë kuadër, raporti synon të sjellë njohuri praktike dhe të ofrojë rekomandime konkrete për politikëbërësit, aktorët dhe profesionistët e përfshirë në sektorin e ndërtimit.

Qëllimi përfundimtar është të mbështesë zhvillimin e një strategjie afatgjatë për rinovimin që do të përmirësojë efikasitetin energjetik, do të ulë varfërinë energjetike, do të rrisë sigurinë në furnizim dhe do të kontribuojë në objektivat klimatike të Shqipërisë dhe Kosovës.

Efiçenca energjetike është bërë çështje kritike për trajtimin e disa prej sfidave më të ngutshme globale, duke përfshirë ndryshimin e klimës, sigurinë energjetike dhe zhvillimin ekonomik. Projekti RenovAID është një nismë strategjike për të rritur efikasitetin energjetik në sektorin e ndërtimit në Shqipëri dhe Kosovë; arsyet për të cilat kjo është thelbësore përfshijnë dekarbonizimin e sektorit të banimit dhe kontributin në kursimet ekonomike.

Rezultatet e këtij hulumtimi do të mundësojnë zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve që mund të përmirësojnë ndjeshëm performancën energjetike të ndërtesave në Shqipëri e Kosovë, duke siguruar një të ardhme më të qëndrueshme dhe elastike për vendin. Projekti RenovAID synon të zhvillojë dhe të zbatojë një sistem të fuqishëm të Certifikatës së Performancës Energjetike (EPC) dhe të krijojë qendra të integruara për rinovimin e shtëpive, duke e bërë më të lehtë për banorët që të gjejnë informacionin dhe shërbimet që u nevojiten për rinovime në efikasitetin energjetik.

Ky raport përforcon gjetjet nga veprimtaritë e ndryshme të projektit në Paketën e Punës I: "Zhvillimi i aftësive të qeverive qendrore e vendore në Kosovë dhe në Shqipëri, për të përmirësuar kornizat e tyre politike për rinovimin e ndërtesave", duke ofruar një analizë gjithëpërfshirëse për sfidat e sotme dhe duke propozuar zgjidhje për të rritur efikasitetin energjetik në këto rajone.

1.1.2. Pyetjet kërkimore

Pyetjet kryesore kërkimore të këtij raporti janë:

- ◆ **Cilat janë problemet dhe pengesat më të hasura në sektorin e ndërtesave në Kosovë dhe Shqipëri?** Kjo pyetje synon të identifikojë

pengesat kryesore që pengojnë zbatimin e praktikave të efijencës energjetike në ndërtesa. Të kuptuarit e pengesave është thelbësor për zhvillimin e strategjive të synuara për t'i trajtuar ato në mënyrë të efektshme.

♦ **Çfarë zgjidhjesh mund të vihen në jetë për të trajtuar këto probleme dhe pengesa?**

Duke u bazuar në identifikimin e pengesave, kjo pyetje synon të gjurmtojë zgjidhje të mundshme dhe praktikatat më të mira që mund të përthithen për të kapërcyer këto sfida.

♦ **Si mund të integrohen këto zgjidhje në kornizat politike të sotshme dhe të ardhshme?**

Kjo pyetje përqendrohet në integrimin praktik të zgjidhjeve të gjetura në kornizat politike të sotme dhe të ardhshme. Ajo shqyrton se si rekomandimet mund të integrohen brenda strukturave ligjore dhe rregullatore të Kosovës dhe Shqipërisë. Qëllimi është të sigurohet që këto zgjidhje të jenë jo vetëm të qëndrueshme në teori, por dhe të realizueshme e të qëndrueshme në afat të gjatë.

Duke trajtuar këto pyetje hulumtuese, raporti synon të zbulojë njohuri të zbatueshme dhe të ofrojë rekomandime konkrete për politikëbërësit, aktorët dhe profesionistët e përfshirë në sektorin e ndërtimit.

Gjetjet nga ky hulumtim do të ofrojnë informacion në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve që mund të sjellin përmirësime me rëndësi për performancën energjetike të ndërtesave në Kosovë e Shqipëri, duke siguruar një të ardhme më të qëndrueshme dhe elastike për vendin.

Në përputhje me këto pyetje kërkimore, në raport hamendësohet që pengesat kryesore për efijencën energjetike në sektorin e ndërtimit janë kufizimet financiare, mungesa e ndërgjegjësimit publik dhe vënia në jetë jo si duhet e politikave. Gjithashtu, mendohet që trajtimi i këtyre pengesave me stimuj financiarë të synuar, fushata edukuese dhe korniza të plota rregullatore do të përmirësojë ndjeshëm rezultatet e efijencës energjetike.

1.2. METODOLOGJIA

1.2.1. Metodologjia e përdorur

Për të kuptuar në mënyrë gjithëpërfshirëse problemet dhe pengesat komplekse që lidhen me efijencën energjetike në sektorin e ndërtimit në Shqipëri dhe Kosovë ishte e nevojshme që të përdorej një metodologji e fuqishme kërkimore. Projekti RenovAID përdori një qasje me një sërë metodash, duke gërshetuar pyetësorët online me takime ballë për ballë ose përmes zoom-it me aktorët kryesorë. Kjo qasje u zgjodh për disa arsye të rëndësishme, që renditen më poshtë.

Qasja me metoda të përziera lejon që të merren parasysh këndvështrime të ndryshme. Efijenca energjetike në ndërtime prek një sërë aktorësh ku

përfshihen institucionet qeveritare, kompanitë e ndërtimit, administratorët e ndërtesave, ekspertët, OJQ-të dhe publiku i gjerë. Cdo grup ofron njohuri dhe përvoja të pashoqe që janë thelbësore për të kuptuar problemet në fjalë.

Ndërsa të dhënat sasiore nga anketat mund të tregojnë prirje dhe të nxjerrin në pah pengesa të zakonshme, të dhënat cilësore nga intervistat dhe takimet mund të sjellin njohuri më të thella mbi shkaqet e tyre. Metodatat cilësore mundësojnë eksplorimin e çështjeve komplekse që nuk mund të kapen plotësisht nga pyetësorët e strukturuar.

Ndërthurja e metodave të ndryshme në mbledhjen e të dhënave siguron që studimi të mbulojë në gjerësi dhe në thellësi përvojën e aktorëve. Kjo ndarje e burimeve të të dhënave përmirëson besueshmërinë dhe vlefshmërinë e gjetjeve, duke ofruar një pamje më gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale të efikasitetit energjetic në sektorët e ndërtimit në Shqipëri e Kosovë.

Qasja me metoda të përziera ofron fleksibilitet po të kihen parasysh kufizimet praktike, si koha dhe disponueshmëria e pjesëmarrësve. Pyetësorët online mund të arrijnë shpejt një numër më të madh të anketuarish, ndërsa takimet sy për sy dhe ato në platformën Zoom mund të përshtaten me oraret dhe disponueshmërinë e secilit.

Qëllimi i përgjithshëm i këtyre pyetësorëve dhe takimeve është të informojnë politikëbërësit dhe të ofrojnë sugjerime praktike. Qasja me disa metoda gjeneron të dhëna të pasura dhe të hollësishme që mbështesin vendimmarrjen e bazuar në prova. Kjo ndihmon në identifikimin e sfidave specifike, kuptimin e nevojave dhe preferencave të aktorëve dhe propozon zgjidhje që u përshtaten atyre.

1.2.2. Përshkrimi i metodologjisë

Metodologjia e përdorur në këtë raport ndërthur qasje cilësore dhe sasiore për të mbledhur njohuri gjithëpërfshirëse:

- ◆ **Analiza sasiore:** Të dhënat nga pyetësorët u analizuan për të identifikuar prirje të zakonshme, modele dhe korrelacione statistikore. Kjo analizë ofroi një pasqyrë të gjerë mbi problemet dhe pengesat kryesore për efikasitetin energjetic në ndërtesa
- ◆ **Analiza cilësore:** Të dhënat cilësore nga takimet u analizuan tematikisht. Tema kryesore, njohuri dhe narrativa u identifikuan dhe u përgjithësuan për të plotësuar gjetjet sasiore. Kjo analizë tërësore mundësoi një kuptim më të thellë të kompleksiteteve dhe të ngjyresave të problemeve të trajtuara.

Metodologjia kërkimore përfshiu dy përbërës kryesorë: një pyetësor online dhe takimet ballë për ballë ose përmes zoom. Kombinimi i këtyre metodave mundësoi një kuptim të detajuar të perceptimeve, sfidave dhe rekomandimeve nga aktorët kryesorë të përfshirë në sektorin e efikasitetit energjetic. Këto metoda ofruan një kornizë të fuqishme për të kapur kompleksitetin dhe thellësinë e çështjeve dhe zgjidhjeve të mundshme. Secili përbërës u skicua dhe u vu në jetë për të maksimizuar cilësinë dhe përkatësinë e të dhënave të mbledhura. Aspektet kryesore përfshijnë:

- ◆ **Përzgjedhja e pjesëmarrësve.** Pjesëmarrësit u përzgjedhën për të përfaqësuar një larmi aktorësh nga institucionet qendrore dhe vendore. Këtu përfshihen ministri, agjenci për efikasitetin energjetik dhe bashki në rajone të ndryshme të Shqipërisë.
- ◆ **Formati i takimeve.** Takimet u mbajtën ose ballë për ballë ose përmes Zoom. Kjo qasje mundësoi fleksibilitet më të madh dhe siguroi përfshirjen e një numri të madh pjesëmarrësish.
- ◆ **Pyetjet udhëzuese.** Takimet u strukturuan rreth një grupi pyetjesh udhëzuese për të eksploruar tema kryesore si angazhimi i qeverisë, përfshirja e qytetarëve, sfidat e rinovimit dhe zgjidhjet e mundshme. Këto pyetje ndihmuan në diskutime të fokusuara dhe produktive, duke gjeneruar të dhëna cilësore të vlefshme.

1.2.3. Mbledhja e të dhënave: Shqipëria

Pyetësi online:

Ky përbërës synonte të mblidhte të dhëna sasiore nga një seri aktorësh të përfshirë në sektorin e ndërtimit. Veçoritë kryesore të këtij komponenti përfshijnë:

- ◆ **Aktorë të synuar.** Pyetësi synonte bizneset e ndërtimit administratorët, e ndërtesave, ekspertët e efikasitetit energjetik dhe OJQ-të, për shkak të përfshirjes dhe ekspertizës së tyre në rinovimin e ndërtesave dhe nismat për efikasitetin energjetik.
- ◆ **Përmbajtja e pyetësorit.** Pyetjet mbulonin tema si informacioni, demografik, sfidat dhe pengesat për efikasitetin energjetik, rolet e aktorëve dhe angazhimi, si dhe zgjidhjet e mundshme. Pyetjet ishin hartuar për të marrë përgjigje specifike dhe perceptime të përgjithshme për efikasitetin energjetik në ndërtesa.
- ◆ **Shkalla e përgjigjeve.** Gjithsej morën pjesë 40 pjesëmarrës, duke tejkaluar objektivin fillestar prej 35. Kjo pjesëmarrje e qëndrueshme ofroi një bazë të fortë për analizën sasiore dhe siguroi një larmi perspektivash.

Takimet konsultative:

Përveç pyetësorit online, u mbajtën takime me institucionet qeveritare (fizikisht dhe përmes Zoom) për të mblidhur të dhëna cilësore dhe për të pasur njohuri më të thella mbi problemet e identifikuara. Në takime u përfshinë përfaqësues nga institucione të ndryshme qeveritare dhe bashkitë. Aspektet kryesore të kësaj metodologjie përfshijnë:

- ◆ **Përzgjedhja e pjesëmarrësve.** Pjesëmarrësit u përzgjedhën për të përfaqësuar një seri aktorësh nga institucionet qendrore dhe lokale në rajone të ndryshme të Shqipërisë. Ata vinin nga ministritë, Agjencia e Efikasitetit të Energjisë dhe bashki nga rajone të ndryshme të Shqipërisë.

- ◆ **Formati i takimeve.** Për shkak të kufizimeve kohore dhe sfidave praktike të planifikimit, këto takime u mbajtën fizikisht ose përmes Zoom-it.
- ◆ **Procedurat e zbatuar.** Takimet u strukturuan rreth pyetjeve të paracaktuara për të eksploruar tema si angazhimi i qeverisë, përfshirja e qytetarëve, sfidat e rinovimit dhe zgjidhjet e mundshme. Këto pyetje ndihmuan në gjenerimin e të dhënave cilësore të vlefshme.

1.2.4. Mbledhja e të dhënave: Kosova

Anketat:

Anketa u zhvillua nga 8 deri më 18 korrik 2024. Karakteristikat kryesore përfshijnë

- ◆ **Përzgjedhja e pjesëmarrësve.** Pjesëmarrësit u përzgjedhën bazuar në përfshirjen e tyre profesionale në sektorin e ndërtimit dhe efijencës energjetike për të siguruar që anketa të pasqyronte mendimet dhe përvojat e një sërë ekspertëve. Pjesëmarrësit ishin arkitektë, inxhinierë, ekspertë energjie, administratorë ndërtesash, profesorë dhe përfaqësues të OJQ-ve relevante dhe prodhuesve të materialeve.
- ◆ **Formati i anketës.** Anketa përfshinte pyetje të mbyllura dhe të hapura për të mbledhur informacion mbi sfidat, nevojat dhe zgjidhjet e mundshme në fushën e efijencës energjetike.
- ◆ **Procedurat e zbatuara.** Të dhënat nga anketat u mbledhën, u përpunuan, dhe u analizuan për të identifikuar temat dhe tendencat kryesore që dhanë informacion për gjetjet dhe rekomandimet e raportit.

Grupi i fokusit:

Grupi i fokusit u mbajt më 1 korrik 2024. Karakteristikat kryesore përfshijnë:

- ◆ **Përzgjedhja e pjesëmarrësve.** Pjesëmarrësit u përzgjedhën për të përfaqësuar një gamë të larmishme aktorësh me ndikim të rëndësishëm në politikat dhe praktikatat e efijencës energjetike. Grupi i fokusit përfshinte përfaqësues të nivelit të lartë nga institucione të rëndësishme si Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, GIZ dhe përfaqësues nga kompani private si ESCO Solar.
- ◆ **Aktivitetet e zbatuara.** Grupi i fokusit përfshinte diskutime të strukturuar mbi çështje kyçe, pengesa dhe zgjidhje të mundshme në lidhje me efijencën energjetike në ndërtesa. Diskutimet u dokumentuan dhe u analizuan për të nxjerrë njohuri dhe rekomandime vendimtare nga ekspertët.
- ◆ **Procedurat e zbatuara.** Diskutimet e grupit të fokusit u zbardhën dhe u analizuan për të nxjerrë në pah temat e rëndësishme dhe perceptimet e ekspertëve, duke kontribuar në një kuptim gjithëpërfshirës të sfondit të efijencës energjetike.

2. Rezultatet

2.1. SHQIPËRIA

2.1.1. Nga intervistat dhe grupet e fokusit

Cjetjet nga pyetësi online dhe takimet konsultative nxjerrin në pah problemet dhe pengesat kryesore të hasura në sektorin e ndërtimit në Shqipëri. Këto përfshijnë kufizimet financiare, mungesën e informacionit dhe angazhimin e pamjaftueshëm të qeverisë, të identifikuara nga aktorë të ndryshëm.

2.1.2. Përgjigjet e dhëna për pyetjet kërkimore

Cilat janë çështjet dhe pengesat më të zakonshme në sektorin e ndërtesave në Shqipëri?

Në sektorin e ndërtimit në Shqipëri, disa pengesa ndikojnë ndjeshëm në adoptimin e praktikave të efikasitetit energjetike. Kufizimet financiare janë ndër sfidat më të theksuara, pasi kostot fillestare të lidhura me rinovimin e ndërtimeve janë tepër të larta. Shumë pronarë hasin vështirësi për të përballuar materialet, teknologjitë dhe fuqinë punëtore të nevojshme, dhe këto probleme thellohen nga mungesa në mundësitë e financimeve për rinovimet energjetike. Për më tepër, kuadri rregullator në Shqipëri është kompleks dhe i pamjaftueshëm për të mbështetur përmirësimet më të mëdha të efikasitetit energjetike. Kuadri ekzistues rregullator nuk arrin të ofrojë udhëzime të qarta, stimuj ose mekanizma zbatimi për të nxitur përputhshmërinë dhe adoptimin e praktikave të efikasitetit energjetike. Kjo krijon një mjedis shkurajues për aktorët, të cilët hasin pengesa burokratike dhe mungesë qartësie rregullatore që i bëjnë të stepen.

Një pengesë tjetër e rëndësishme është mbështetja e teknologjitë e vjetëruara dhe joefikase në shumë ndërtime. Mungesa e aksesit në teknologjitë moderne të efikasitetit energjetike, së bashku me mungesën e përvojës për zbatimin dhe mirëmbajtjen e tyre, paraqet një sfidë të konsiderueshme. Gjithashtu, projektimi dhe struktura e ndërtesave të vjetra shpesh e komplikojnë integrimin e teknologjive të reja, duke kërkuar modifikime të konsiderueshme. Infrastruktura ekzistuese, përfshirë rrjetet elektrike dhe sistemet e ngrohjes, është shpesh e papërputhshme me përmirësimet e efikasitetit energjetike, duke kërkuar ndryshime të thella.

Faktorët socialë gjithashtu pengojnë përparimin. Ndërgjegjësimi dhe angazhimi publik në nismat për efikasitet energjetike janë të ulëta, dhe pjesa më e madhe e individëve dhe komuniteteve nuk i njohin mirë përfitimet afatgjata. Kjo çon në një priorizim minimal të praktikave të efikasitetit energjetike, të pasuara nga rezistenca kulturore ndaj ndryshimeve dhe preferenca për metodat tradicionale të ndërtimit.

Cilat janë zgjidhjet për këto probleme dhe pengesa?

Për të trajtuar në mënyrë efektive pengesat në sektorin e ndërtimit në Shqipëri, janë propozuar një sërë zgjidhjesh gjithëpërfshirëse. Në aspektin financiar, futja e subvencioneve dhe granteve të fokusuara specifiku në rinovimet energjetike mund të ndihmojë në uljen e barrës financiare për pronarët dhe të nxisë përhapjen më të gjerë të këtyre praktikave. Përveç kësaj, ofrimi i huave me interesa të ulëta përmes programeve qeveritare ose partneriteteve me institucione financiare mund të lehtësojnë investimet në eficientë energjetike.

Në aspektin rregullator, Shqipëria ka nevojë për një kuadër të fortë politikash që ofron udhëzime të qarta, stimuj dhe mekanizma zbatimi për të mbështetur praktikën e eficientë energjetike në të gjithë sektorët. Thjeshtimi i proceseve rregullatore dhe reduktimi i pengesave burokratike do ta bëjnë më të lehtë për aktorët që të përdorin sistemin dhe të zbatojnë masat për eficientë energjie.

Në aspektin teknologjik, lehtësimi i aksesit në teknologjitë moderne të eficientë energjetike përmes programeve qeveritare ose partneriteteve publike-private mund të ndihmojë në trajtimin e këtyre pengesave. Kjo mund të përfshijë stimuj tatimorë për importimin e produkteve me eficientë energjie ose subvencione për blerjen e këtyre teknologjive. Për më tepër, investimi në ngritje kapacitetesh dhe programe trajnimi për profesionistët e sektorit të ndërtimit mund të mbyllë hendekun e njohurive. Këto programe duhet të fokusohen në teknologjitë më të fundit, praktikën më të mira dhe mirëmbajtjen e sistemeve të eficientë së energjisë.

Promovimi i projekteve të ndërtesave që janë të lehta për t'u përshtatur (retrofit-friendly) është një tjetër zgjidhje kyçe. Inkurajimi i ndërtimit të banesave të reja për të përfshirë projekte me eficientë energjie që në fillim do ta bënte më të lehtë dhe më pak të kushtueshme përmirësimet e ardhshme. Për ndërtesat ekzistuese, investimi në përmirësimet e infrastrukturës, si përmirësimi i rrjeteve elektrike dhe sistemeve të ngrohjes, është i nevojshëm për të mbështetur integrimin e teknologjive moderne të eficientë energjetike. Këto përmirësime do të siguronin që infrastruktura ekzistuese të mund të përballonte ngarkesën e shtuar dhe të funksiononte në mënyrë efikase.

Si mund të integrohen këto zgjidhje në kuadrin aktual dhe të ardhshëm të politikave?

Për të integruar këto zgjidhje në kornizat politike të sotme dhe të ardhshme, Shqipëria duhet të ndjekë një qasje strategjike. Së pari, përmirësimi i kuadrit politik është thelbësor. Kjo përfshin zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe të zbatueshme që ofrojnë stimuj financiarë, udhëzime të qarta dhe rregullore të thjeshtuara për të lehtësuar pajtueshmërinë dhe adoptimin e praktikave të eficientë së energjisë. Politikën, gjithashtu, duhet projektuar që të jenë të hapura për përditësime, duke lejuar përshtatjen me teknologjinë dhe praktikën të reja.

Forcimi i mekanizmave të mbështetjes financiare është tjetër hap kritik. Qeveria duhet të krijojë skema financimi, si subvencione, grante dhe hua me interesa të ulëta, që janë të fokusuara posaçërisht në projekte për eficientë energjetike. Këto mekanizma do të ndihmonin në kapërcimin e barrierës së kostove të larta fillestare, duke e bërë rinovimin e eficientë energjetike më të përballueshme për pronarët.

Investimi në programet për ndërtimin e kapaciteteve është po aq i rëndësishëm. Duke mbështetur trajnimin dhe zhvillimin profesional për ata që punojnë në sektorin e ndërtimit, Shqipëria mund të sigurojë një forcë pune të kualifikuar që është gati për të zbatuar dhe mirëmbajtur në mënyrë efektive teknologjitë e eficientës energjetike. Ky investim në kapitalin njerëzor është thelbësor për suksesin afatgjatë të nismave për eficientën energjetike.

Angazhimi publik duhet gjithashtu të jetë një përparësi. Nisja e fushatave të gjera ndërgjegjëse publike për të edukuar qytetarët mbi përfitimet e eficientës energjetike, si mjedisore ashtu edhe ekonomike, do të ndihmojë në krijimin e një kulture të efikasitetit energjetik. Angazhimi i komuniteteve përmes qasjeve pjesëmarrëse, si konsultimet publike dhe punëtoritë, do të sigurojë që masat për eficientë energjetike të jenë në përputhje me nevojat dhe preferencat e popullatës, duke rritur gjasat për zbatim të suksesshëm.

Përmirësimi i infrastrukturës është gjithashtu i domosdoshëm për të mbështetur adoptimin e teknologjive moderne të eficientës energjetike. Investimet në përmirësimin e rrjeteve elektrike, sistemeve të ngrohjes dhe infrastrukturave të tjera kritike do të sigurojnë që këto sisteme të jenë të afta për të përballuar kërkesat e teknologjive me efikasitet energjetik, duke lehtësuar integrimin e tyre. Duke adresuar këto fusha kyçe, Shqipëria mund të krijojë një mjedis mbështetës për përhapjen e gjerë të praktikave të eficientës energjetike, duke çuar përfundimisht në përmirësim të ndjeshme në sektorin e ndërtimit.

2.1.3. Shkalla në të cilën përgjigjet konfirmojnë/ përgënjeshtrojnë hipotezën e kërkimit

Hipoteza e kërkimit ishte që pengesat kryesore për eficientën energjetike në sektorin e ndërtimit janë kufizimet financiare, mungesa e ndërgjegjësimit publik dhe kuadri rregullator i papërshtatshëm. Rezultatet nga intervistat dhe grupet e fokusit mbështesin fuqimisht këtë hipotezë: kufizimet financiare u identifikuan vazhdimisht si pengesa më e rëndësishme, me aktorët që theksojnë kostot e larta dhe aksesin e kufizuar në financime. Gjithashtu, mungesa e ndërgjegjësimit dhe angazhimit publik u theksua si një çështje kritike, duke e vërtetuar më tej hamendjen. Ndërsa hipoteza identifikoi saktë këto pengesa kryesore, kërkimi zbuloi gjithashtu sfida shtesë, si kufizimet teknologjike dhe problemet strukturore në ndërtimet ekzistuese, të cilat nuk ishin parashikuar qartë në hamendjen fillestare. Megjithatë, këto gjetje nuk e kundërshtojnë hipotezën; përkundrazi, ato e zgjerojnë kuptimin mbi pengesat e larmishme dhe të ndërlidhura për përmirësimin e eficientës energjetike në Shqipëri.

Në përgjithësi, të dhënat e mbledhura nga intervistat dhe grupet e fokusit mbështesin hipotezën fillestare dhe ofrojnë një kuptim më të detajuar mbi sfidat specifike dhe zgjidhjet e mundshme për përmirësimin e eficientës energjetike në sektorin e ndërtimit në Shqipëri. Rezultatet tregojnë një njohje të pengesave kryesore, veçanërisht kufizimet financiare, por gjithashtu zbulojnë se kapërcimi i këtyre sfidave do të kërkojë një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin përmirësim teknologjike dhe infrastrukturor, së bashku me mbështetje më të mirë financiare dhe rregullatore.

2.2. KOSOVA

2.2.1. Nga intervistat dhe grupet e fokusit

Intervistat dhe grupet e fokusit të zhvilluara si pjesë e projektit RenovAID sjellin njohuri të vlefshme për gjendjen e efikasitetit energjetik në Kosovë. Pjesëmarrësit përfshinin një larmi aktorësh, si zyrtarë, profesionistë të ndërtimit, ekspertë të energjisë dhe përfaqësues nga OJQ-të. Të dhënat e mbledhura zbuluan një kuptim gjithëpërfshirës të gjendjes aktuale të efikasitetit energjetik në ndërtime, duke theksuar disa probleme kritike dhe zgjidhje të mundshme.

2.2.2. Përgjigjet që ata japin për pyetjet kërkimore

Cilat janë problemet dhe pengesat më të zakonshme në sektorin e ndërtesave në Kosovë?

Një nga pengesat më të rëndësishme të identifikuar ishte kufizimi financiar me të cilin përballen aktorët. Kostot e larta fillestare për zbatimin e masave të efikasitetit energjetik, së bashku me aksesin e kufizuar në financime dhe stimuj financiarë, u theksuan si pengesa kryesore. Të dhënat e anketës treguan se mbi 70% e të anketuarve identifikuan problemin financiar si pengesën kryesore për përmirësimet e efikasitetit energjetik. Kjo barrë financiare rëndohet më tej nga kostot e larta fillestare të investimeve për efikasitetin energjetik dhe çmimi i ulët mesatar i energjisë, që pengon përfshirjen e sektorit privat.

Ndërsa janë bërë përpjekje për të zhvilluar një kuadër ligjor për efikasitetin energjetik, zbatimin dhe forcimin e këtyre rregulloreve mbeten problematike. Diskutimet në grupet e fokusit zbuluan që, ndonëse ka ligje të përshtatshme, aftësia e shoqërisë kosovare për të përmbushur kërkesat ligjore është e kufizuar.

Ka një mungesë të udhëzimeve të qarta dhe mekanizmave të zbatimit për të garantuar pajtueshmërinë me standardet e efikasitetit energjetik. Çështja parësore është nevoja për rregullim ligjor, veçanërisht për performancën energjetike të ligjit të ndërtesave. Veprimet e fundit përfshijnë miratimin e Direktivës Evropiane për performancën e energjisë, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri 29.07.2024.

Një tjetër pengesë e rëndësishme është niveli i ulët i ndërgjegjësimit dhe angazhimit publik për përfitimet nga efikasiteti energjetik. Pjesëmarrësit në anketë dhe fokus grup vunë re se shumë pronarë dhe banorë nuk i kuptojnë plotësisht përfitimet nga kursimet e mundshme financiare dhe mjedisore të lidhura me praktikën e efikasitetit të energjisë. Kjo mungesë e vetëdijes pengon adoptimin e teknologjive dhe praktikave të efikasitetit të energjisë. Fushatat ndërgjegjëse janë të nevojshme për të edukuar publikun për rëndësinë dhe përfitimet e certifikimit të energjisë.

Teknologjitë e vjetruara dhe joefikase në shumë ndërtime janë gjithashtu një pengesë. Mungesa e qasjes në teknologjitë moderne, efikase në energji dhe njohuri të kufizuara për përfitimet dhe metodat e zbatimit të tyre e zgjerojnë më tej problemin. Stoku i ndërtesave të Kosovës, kryesisht i ndërtuar pas viteve 1960, nuk është efikas sipas standardeve moderne. Përveç kësaj, veçoritë strukturore të ndërtesave ekzistuese, veçanërisht të atyre të ndërtuara më parë, paraqesin sfida për rinovimin.

Është e nevojshme të identifikohen ndërtesat ekzistuese dhe të krijohet një bazë të dhënash për to, që është një sfidë e madhe, por thelbësore për planifikimin strategjik. Megjithatë, barriera organizative të tilla si bashkërendimi i kufizuar mes palëve të interesuara dhe trajnimi i pamjaftueshëm për profesionistët e efikasitetit energjetik u theksuan nga të anketuarit si çështje për t'u trajtuar. Numri i vogël i stafit të përfshirë në këto projekte shkakton vonesa.

Cilat janë zgjidhjet për këto çështje dhe pengesa?

Për të trajtuar pengesat financiare, pjesëmarrësit rekomanduan futjen e stimujve më të fortë financiarë, si subvencione, grante dhe kredi me interes të ulët. Mekanizmat financiarë mund të ndihmojnë në uljen e barrës fillestare për pronarët dhe të nxisin përvetësimin e praktikave të efikasitetit të energjisë. Për më tepër, krijimi i fushatave financiare dhe rritja e ndërgjegjësimit të publikut rreth mbështetjes financiare të disponueshme mund të nxisë angazhimin e mëtejshëm.

Përmirësimi i kuadrit rregullator për të siguruar udhëzime, stimuj dhe mekanizma zbatimi më të qarta është thelbësor. Kjo përfshin plotësimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për të trajtuar problemet me efikasitetin energjetik. Publikimi i gjerë dhe zbatimi i duhur i këtyre rregullave mund të ndihmojnë në rritjen e pajtueshmërisë dhe të nxisin përmirësime në efikasitetin e energjisë. Regjistri kombëtar duhet të përfshijë të gjitha ndërtesat e reja dhe ekzistuese, duke u siguruar që ato janë në përputhje me kërkesat e certifikimit.

Zbatimi i fushatave gjithëpërfshirëse të ndërgjegjësimit publik për të edukuar qytetarët mbi përfitimet e efikasitetit energjetik është i domosdoshëm. Këto fushata duhet të nxjerrin në pah përfitimet mjedisore dhe ekonomike, duke nxitur kështu një kulturë të efikasitetit energjetik. Angazhimi i liderëve të komunitetit dhe përdorimi i kanaleve të ndryshme të mediave mund të ndihmojë për të arritur një audiencë më të gjerë.

Lehtësimi i qasjes në teknologji moderne përmes programeve qeveritare ose partneriteteve publiko-private mund të ndihmojë në kapërcimin e pengesave teknologjike. Kjo përfshin ofrimin e subvencioneve ose stimujve tatimorë për blerjen e pajisjeve me efikasitetin energjetik dhe teknologjitë e rinovimit.

Investimi në programe për ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimin e profesionistëve në sektorin e ndërtimit dhe energjisë është jetik. Këto programe duhet të përqendrohen në teknologjitë më të fundit, praktikat më të mira dhe mirëmbajtjen e sistemeve efikase në energji. Përmirësimi i aftësive dhe njohurive të këtyre profesionistëve mund të sigurojë zbatimin efektiv të masave të efikasitetit energjetik.

Rritja e koordinimit mes palëve të interesuara përmes platformave më të mira të komunikimit dhe bashkëpunimit mund të adresojë barrierat organizative. Krijimi i roleve dhe përgjegjësive të qarta, dhe nxitja e partneriteteve ndërmjet agjencive qeveritare, enteve të sektorit privat dhe OJQ-ve mund të përdhijn veprime kolektive drejt efijencës së energjisë. Inkurajimi i pjesëmarrjes së sektorit privat, veçanërisht përmes modeleve SCO (Kompanitë e Shërbimit të nergjisë), është thelbësor.

Zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për renovimin e ndërtesave është thelbësor për arritjen e objektivave të efijencës energjetike. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare si LuxDev dhe BRZH është jetik për hartimin dhe zbatimin e strategjive efektive. Fushatat për legalizimin e ndërtesave të paregjistruara dhe përfshirja e tyre në nismat për efijencë energjetike, së bashku me grante dhe stimuj të posaçëm për të përmbushur standardet e performancës energjetike, janë hapa të nevojshëm.

Si mund të integrohen këto zgjidhje në kornizat aktuale dhe të ardhshme të politikave?

Të dhënat e mbledhura nga anketat dhe grupet e fokusit në Kosovë ofrojnë një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për integrimin e zgjidhjeve në politikat aktuale dhe të ardhshme për të rritur efijencën energjetike në ndërtesa. Pengesat financiare të theksuara nga shumica e të anketuarve tregojnë nevojën urgjente për stimuj financiarë. Këta stimuj duhet të përfshihen si në buxhetet kombëtare aktuale ashtu dhe në ato të ardhshme, duke ofruar procese të thjeshtuara aplikimi dhe financime të vazhdueshme për mbështetjen e renovimeve energjetike.

Gjithashtu, nevoja për një kuadër rregullator të fortë ishte një pikë me rëndësi, me fokus në finalizimin dhe zbatimin e rregulloreve për performancën energjetike të ndërtesave, rritjen e kapacitetit të rregullatorëve dhe krijimin e një sistemi transparent monitorimi dhe vlerësimi.

Fushatat e ndërgjegjësimit dolën si një zgjidhje kyçe, duke pasur parasysh nivelin e ulët të ndërgjegjësimit si një pengesë e madhe. Hapat e menjëhershme duhet të përfshijnë nisjen e fushatave kombëtare përmes kanaleve të ndryshme mediatike dhe angazhimin e liderëve të komunitetit për të edukuar qytetarët mbi përfitimet e efijencës energjetike. Nismat e ardhshme duhet të integrojnë edukimin mbi efijencën energjetike në programet e shkollës dhe të komunitetit, duke siguruar që përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit të jenë të vazhdueshme dhe të përputhshme me teknologjitë dhe praktikat e reja.

Qasja në teknologji moderne dhe programet për ngritjen e kapaciteteve për profesionistët janë gjithashtu thelbësore, duke kërkuar zbatimin e stimujve tatimorë, subvencioneve dhe programeve të specializuara të trajnimit për të rritur aftësitë dhe njohuritë në sektorin e efijencës energjetike.

Përmirësimi i koordinimit organizativ dhe planifikimit strategjik për rinovimin ishin gjithashtu rekomandime kyçe. Krijimi i "task-forcave" dhe nxitja e partneriteteve publiko-private mund të përmirësojë bashkëpunimin dhe të shfrytëzojë burimet dhe ekspertizën. Zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse kombëtare për rinovim me qëllime dhe afate të qarta kohore do të jetë kyç për

